



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 29, Datë 30.01.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “REJ ENERGY” SH.P.K., PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 177, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 120 DATË 29.08.2012.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 15 të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016; neni 19 pika 1 gërma “a” të “*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë “REJ ENERGY” sh.p.k., për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatohet se:

Shoqëria “Rej Energy” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Cemerica 1” me fuqi të instaluar 0.88 MW; “Cemerica 2” me fuqi të instaluar 0.9 MW; “Cemerica 3” me fuqi të instaluar 2.1 MW, me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120, datë 29.08.2012.

Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Rej Energy” sh.p.k., në bazë të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, rezulton si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, gërma “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës : Plotësuar.
- Neni 15, pika 4, gërma “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence : Plotësuar.
- Neni 15, pika 4, gërma “c”: Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera: Pa plotësuar. Nuk është paraqitur miratimi i projektit të rritjes së fuqisë nga Autoritetit Kontraktues.

- Neni 15, pika 4, gërma “d”: Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi : Plotësuar.
- Neni 15, pika 4, gërma “e”: Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE : Plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4, gërma “c”, do të njoftohet subjekti që në bazë të neni 11, pika 1 të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së Shoqërisë “REJ ENERGY” sh.p.k., dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120 datë 29.08.2012, me nr. 177, Seria PV12K për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec-et “Cemeric 1” me fuqi të instaluar 0.88 MW; “Cemeric 2” me fuqi të instaluar 0.9 MW; “Cemeric 3” me fuqi të instaluar 2.1 MW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit AHMETI